



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

Raport Konsultativ

Tarifa e rregulluar 220kV

DEKLARATË

Ky Raport Konsultativ është përgatitur nga ZRRE për të marrë komente eventuale nga palët e interesit. Dokumenti nuk paraqet vendim të ZRRE-së.

Prishtinë, 4 prill 2011

Hyrja

Përmbajtja

1	Hyrja.....	3
2	Baza ligjore.....	3
3	Tarifa e propozuar 220kV.....	4

1 Hyrja

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka marrë njoftim me datën 23 mars 2011 për aplikacionin e NewCo Ferronikeli Complex sh.p.k. (Ferronikeli) që të furnizohet nga Korporata Energjetike e Kosovës sh.a. (KEK) në bazë të licensës së Furnizuesit Publik, pas skadimit më 18 prill 2011 të kontratës ekzistuese të parregulluar të furnizimit në mes të këtyre dy subjekteve. Sipas ligjeve në fuqi, furnizimi i një konsumatori të kualifikuar nga Furnizuesi Publik bëhet në tarifën e parregulluar, përveç nëse nuk ekziston konkurrencë efektive në furnizim. Në këtë rast, kërkohet nga ZRRE-ja që të përcaktojë tarifën e rregulluar për furnizim.

Ky Raport Konsultativ paraqet bazën ligjore sipas së cilës aplikohet tarifa e rregulluar dhe propozimet e ZRRE-së për tarifën e rregulluar që do të aplikohet për konsumatorët e kyçur në 220kV, në rast se nuk ekziston konkurrencë efektive në furnizim. ZRRE-ja ka publikuar më herët për konsultim kriteret e saj të propozuara që do të zbatohen për të përcaktuar nëse ekziston konkurrencë efektive në furnizim.

ZRRE-ja synon të nxjerrë një vendim në lidhje me atë se a duhet të aplikohet tarifa e rregulluar për shitjet nga Furnizuesi Publik te konsumatorët e kyçur në 220kV dhe, nëse po, në formën e kësaj tarife, së bashku me vendimin e saj për tarifën e tjera të rregulluara me pakicë. Konsultime të ndara janë duke u bërë në lidhje me këtë vendim.

ZRRE-ja mirëpret të gjitha palët e interesuara që të dërgojnë komente për qëndrimet e saj të paraqitura në këtë Raport. Komentet do të pranohen deri më 8 prill 2011 dhe duhet të dërgohen me email në ero.pricing-tariffs@ero-ks.org, me temën "Komente për Tarifën e rregulluar 220kV" ose me shkrim në adresën e treguar në faqen e parë, me shënimin për vëmendjen e "Departamentit të Çmimeve dhe Tarifave".

2 Baza ligjore

Dispozitat përkatëse të legjisllacionit janë:

- *Neni 6 (6.2) i Ligjit për Energjinë elektrike (Nr. 03/L201)*. Me të cilin Furnizuesit publik (KEK-ut) vendoset obligimi për të furnizuar konsumatorët e kualifikuar sipas kërkesës. Formulimi i nenit është si vijon:

6. Furnizuesi publik do të:

...

6.2 furnizojë energji elektrike për konsumatorët e kualifikuar nëse kërkohen për të bërë një gjë të tillë, me kusht që ky furnizim bëhet vetëm në tarifa të rregulluara të përcaktuara nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë për konsumatorë të tillë të kualifikuar, si dhe sipas kushteve që mund t'i përcaktojë Zyra e Rregullatorit për Energji;

Tarifa e propozuar 220kV

- *Neni 41(1.1) i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 03/L185).* Me këtë ZRRE-së vetëm i mundësohet që të caktojë tarifën e rregulluar për furnizimin e konsumatorëve të kualifikuar nga Furnizuesi publik, në rastin kur ZRRE-ja vlerëson se nuk ka konkurrencë efektive në furnizim. Formulimi i nenit është si vijon:
 - Zyra e Rregullatorit të Energjisë mund të vendosë tarifën të cilat u ngarkohen konsumatorëve të kualifikuar nga ndërmarrja e energjisë elektrike e cila është bartëse e licencës për furnizim publik vetëm kur Zyra nuk është e kënaqur me efektshmërinë e konkurrencës në furnizimin e energjisë elektrike.
- *Neni 41(1.3) i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 03/L185).* Me këtë obligohet ZRRE-ja që përcaktimin se nuk ekziston konkurrencë efektive në furnizim ta bazojë në një vlerësim të publikuar të tregut. Formulimi i nenit është si vijon:
 - 1.3. Çdo konstatim nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë se konkurrenca në furnizimin e energjisë elektrike nuk është efektive duhet të bazohet në një vlerësim gjithëpërfshirës dhe të publikuar të kushteve të tregut. Rregullimi i tarifave nuk do të tejkalojë masën e nevojshme për kompensimin e mungesës së konkurrencës efektive.

Nenet e sipërpërmendura e bëjnë të obligueshme që të gjitha furnizimet për konsumatorët e kualifikuar të bëhen përmes tarifës së parregulluar. Megjithatë, tarifa e rregulluar mund të aplikohet sa herë që ZRRE-ja nuk është e kënaqur me nivelin e konkurrencës në furnizim. ZRRE-ja propozon tarifën e rregulluar për konsultim, mbi bazë të supozimit që ZRRE-ja do të vendosë që tarifa e rregulluar do të aplikohet.

3 Tarifa e propozuar 220kV

KEK-u ka propozuar që tarifa 220kV duhet të vendoset në përputhje me këto parime:

- Tarifa mesatare 220kV duhet të jetë e barabartë me tarifën mesatare të rregulluar 110kV, me një rregullim të vogël për të reflektuar nivelin më të ulët të humbjeve në furnizimin e konsumatorëve të kësaj në 220kV.
- Gjysma e të hyrave duhet të mblidhet përmes tarifës së kërkesës (kW). Kjo tarifë do të bazohet në kërkesën e parashikuar (ose "kontratës") së Ferronikelit dhe jo në kërkesën faktike. Si pasojë, në qoftë se kërkesa faktike e Ferronikelit është nën nivelin e parashikuar, Ferronikeli do të vazhdojë të paguajë në bazë të kërkesës së parashikuar.
- Në rastet kur kërkesa e realizuar e Ferronikelit e tejkalon kërkesën në kontratë do të aplikohet gjyba e cila do të mbulojë kostot e furnizimeve shtesë për të përmbushur kërkesën e tillë të tepërtë.
- Pjesa e mbetur e të hyrave do të mblidhet përmes një tarife fikse të energjisë.

Tarifa e propozuar 220kV

Ferronikeli është konsumatori i vetëm i kyçur në 220kV dhe, rrjedhimisht, konsumatori i vetëm për të cilin do të aplikohet kjo tarifë. ZRRE-ja e kupton se Ferronikeli është pajtuar përkohësisht me këto parime.

Tarifa 220kV e propozuar e KEK-ut që ndjek këto parime është përfshirë në aplikacionin e tij për tarifën e rregulluar me pakicë për t'u aplikuar në vitin 2011. Tarifa mesatare 220 kV që do të rezultonte, duke përdorur shitjet e parashikuara dhe parakushtet e kërkesës për Ferronikelin në vitin 2011, është rreth 4.16 €/kWh. Kjo krahasohet me vlerësimin paraprak të ZRRE-së të tarifës mesatare të aplikueshme për konsumatorët 110kV në vitin 2011, duke supozuar se tarifën e tanishme nuk do të ndryshojnë, prej 4.26 €/kWh.

Në përcaktimin e tarifës së rregulluar në 220kV, ZRRE-ja konsideron që duhet të përmbushen këto parakushte:

- Edhe pse struktura e tarifave mund të ndryshojë sipas kategorive të konsumatorëve, niveli i mesatar i tarifave për konsumatorët e kyçur në 220kV në bazë të tarifës së rregulluar duhet të vendoset në një nivel të arsyeshëm kur krahasohet me tarifën e konsumatorëve të tjerë të rregulluar.
- Tarifa e rregulluar nuk duhet të sjellë rreziqe të panevojshme për konsumatorët e tjerë të rregulluar. Në veçanti, duke pasur parasysh rëndësinë e kërkesës së Ferronikelit (që përfaqëson mbi 11% të shitjeve totale të energjisë elektrike), konsumatorët tjerë nuk duhet të paguajnë kostot e kontratave të importit në të cilat Furnizuesi Publik mund të ketë hyrë duke pasur parasysh një kërkesë të caktuar të Ferronikelit, të cilën Ferronikeli mund të mos e realizojë.

ZRRE-ja konsideron se parimet e propozuara nga KEK-u i përmbushin këto parakushte. Vendosja e nivelit të tarifës mesatare për tarifën 220 kV në nivel më të ulët se niveli i tarifës mesatare ekzistuese të 110 kV do të sigurojë arsyeshmërinë e tarifës së rregulluar në raport me tarifën tjetër. Obligimi i Ferronikelit që të paguajë një pjesë të madhe të tarifave në formën e tarifës së kërkesës në kontratë do të sigurojë mbrojtje kundër kërkesës së realizuar të Ferronikelit që mund të ndryshojë nga kërkesa e parashikuar.

ZRRE-ja propozon të bëjë tri ndryshime në aplikacionin për tarifën të dorëzuar nga KEK-u:

- Aplikacioni i KEK-ut i supozon humbjet totale të transmisionit prej 3.1%, në përputhje me humbjet e lejuara të ZRRE-së në 2010. Nga kjo, KEK-u ka zbritur humbjet e vlerësuara paraprakisht të transmisionit në nivelin 110kV në 1.5%, për të dhënë humbjet e vlerësuara paraprakisht të transmisionit në nivelin 220 kV në 1.6%. Për vitin 2011, ZRRE-ja propozon të lejojë humbjet e transmisionit në 2.3%. ZRRE-ja propozon që, në përcaktimin e tarifës së rregulluar për konsumatorët 220kV, të zbrisë 1% nga ky nivel i lejuar për të dhënë humbjet e vlerësuara paraprakisht të transmisionit në nivelin 220 kV në 1.3%. Kjo do të rrisë në masë të vogël tarifën mesatare në raport me atë të projektuar nga KEK-u.

Tarifa e propozuar 220kV

- Aplikacioni i KEK-ut supozon se Ferronikeli do të jetë përgjegjës për të gjitha tarifat e shrytëzimit të sistemit të transmisionit (SHST) të aplikuara nga KOSTT-i, të cilat KEK-u do t'i paguajë në emër të Ferronikelit. Meqë Ferronikeli është i kyçur në nivel të tensionit prej 220 kV, nuk do të jetë përgjegjës për tarifat SHST që lidhen me shfrytëzimin e rrjetit të transmisionit 110kV. Në përcaktimin e tarifës së rregulluar për konsumatorët 220kV, ZRRE-ja propozon që të zbresë taksat SHST të aplikueshme për konsumatorët kyçur në nivelin 110kV. Kjo do të zvogëlojë në masë të vogël tarifën mesatare në raport me atë të projektuar nga KEK-u.
- Aplikacioni i KEK-ut supozon që e njëjta tarifë e konsumatorëve të aplikohet për konsumatorët 220kV dhe 110kV. ZRRE-ja konsideron se është e përshtatshme të rritet tarifa e konsumatorit duke njohur kërkesat më të mëdha të konsumatorëve më të mëdhenj për faturim dhe shërbime të tjera të shitjes me pakicë. Për këtë arsye, ZRRE-ja propozon të dyfishojë tarifën e konsumatorëve të aplikuar për konsumatorët e 110kV në përcaktimin e tarifave të 220kV. Kjo do të rrisë paksa tarifën mesatare 220kV.

Ndikimi i kombinuar i këtyre tre modifikimeve paraqet një rënie të vogël të tarifës mesatare 220kV të rregulluar në raport me atë të propozuar nga KEK-u. Vetë llogaritja e ZRRE-së është se tarifa mesatare 220 kV do të ishte 4.14 €/kWh ose 2.9% nën tarifën mesatare 110kV.

ZRRE-ja propozon të miratojë tarifën e rregulluar 220kV në përputhje me këtë mesatare, duke aplikuar po ashtu të njëjtën strukturë tarifore siç është propozuar nga KEK-u. Konvertimi nga kjo mesatare në nivelet e tarifave të energjisë dhe kërkesës do të bëhet duke përdorur përcaktuesit e njëjtë të faturimit për vitin 2011 sic janë përdorur nga KEK-u në propozimin e tij¹.

¹ ZRRE-ja e ka modifikuar pak bilancin e energjisë të përfshirë nga KEK-u në aplikacionin e tij të tarifave. Këto ndryshime kanë të bëjnë me humbjet e supozuara komerciale dhe teknike në tensionet e shpërndarjes dhe nuk ndikojnë në energjinë dhe kërkesën e parashikuar të Ferronikelit. Dokumenti i veçantë i Përgjigjeve mbi tarifat tjera të rregulluara me pakicë, lëshuar së bashku me këtë Raport konsultativ, ofron më shumë të dhëna.